



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 1651/4 Prot.

Shkodër, më 05 / 11 /2024

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

Vendimin Nr.1651/1prot., datw 08.10.2024 "për rikuperimin e borxhit doganor" i Degës së Doganës Shkodër ndaj subjektit "GREEN POWER ENERGY" SHPK me NIPT L56927002A, dhe adresë në: Rruga Nacionale Shkodër - Velipojë Km 7, Zona Kadastrale 1158, nr. pasurise 146/11 Godina 2 katëshe, kati parë Shkodër, Bërdicë, cel: 067366663.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS SHKODËR

Nr. 1651/Prot.

Shkodër, më 08/10/2024

V E N D I M

**Për rikuperimin me forcë të borxhit doganore ndaj debitorit
“GREEN POWER ENERGY” SHPK me NIPT L56927002A**

Dega e Doganës Shkodër me vendimin Nr. 23, datë 08.08.2024 ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën totale **250.404 lekë**, për debitorin “GREEN POWER ENERGY” SHPK me NIPT L56927002A, me administrator z. Serdar Hoxha dhe adresë në: Rruga Nacionale Shkodër - Velipojë Km 7, Zona Kadastrale 1158, nr. pasurise 146/11 Godina 2 katëshe, kati parë Shkodër, Bërdicë, cel: 067366663.

Ky vendim i është komunikuar debitorit të mësipërm, sipas shkresë Nr.569/2 datë 08.08.2024 me Lajmerim marrje dhe Kod Postar RR 640 729 901 AA i cili është kthyer me shënimin “larguar”. Me shkresë Nr.569/4prot., datë 27.08.2024 kemi bërë shpallje publike ne Dege (e afishuar nga data 27.08.2024-07.09.2024). Me shkresë Nr.569/3prot., datë 27.08.2024 kemi bërë shpallje publike ne “faqen zyrtare DPD” (afishuar me shkresën Nr.18160/1 datë 16.09.2024). Me shkresë Nr.569/5prot., datë 27.08.2024 kemi bërë kërkesë për shpallje publike në QKB (e afishuar sipas shkresë Nr.12601prot., datë 29.08.2024). Debitorit megjithëse i ka kaluar afati ligjor i ankimit dhe afati i ekzekutimit vullnetare, nuk ka likuiduar borxhin doganor të lindur sipas vendimit të sipërpërmendur.

Në këto kushte në bazë të vendimit sipërpërmendur të Degës Doganës Shkodër, me qëllim rikuperimin me forcë të borxhit doganore në shumën prej **250.404 lekë** për debitorin “GREEN POWER ENERGY” SHPK me NIPT L56927002A, që ka ndaj Degës Doganës Shkodër, në zbatim të nenit 280 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 511 e vijues të K. Pr. Civile dhe udhëzimit Nr.15 datë 03.12.2018 të Drejtorisë Përgjithshme Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

V E N D O S A Q Ë :

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit subjekti “GREEN POWER ENERGY” SHPK me NIPT L56927002A, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuar në **vendimin Nr. 23 datë 08.08.2024** të Degës së Doganës Shkodër, **si dhe të kamatë vonesave të lindura** në bazë të nenit 280 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.
4. Pas njoftim të këtij subjekti për "*vendimit të rikuperimit me forcë të borxhit doganore*", subjekti juaj do bllokohet në sistemin AW për te kryer veprime doganore.

KRYETAR

Aida DIZDARI

